



Drejtimi i zhvillimit energjetik të Maqedonisë ka ndikim të madh ndaj rritjes nacionale dhe ekonomike si dhe ndaj mbrojtjes së ambientit. Për shumë amvisëri në Maqedoni, harxhimet mujore për energji paraqesin harxhim më i lartë në buxhetin familjar pas ushqimit. Siç mund të shihni nga fotografia, shtëpia është ndarë në dy pjesë. Tentoni të shihni ku më së shumti humbet energjia dhe ku mund më së miri të kursehet energjia.



Kulmi
Në një amvisëri mesatare një e treta e nxehtësisë humbet përmes kulmit. Kulmi pa izolim është shpenzuesi më i madh i energjisë! Ka shumë mënyra të përdorimit të sipërfaqes së kulmit. Për shembull: në vendet perëndimore në kulmet gjithnjë e më shpesh mbillet bar dhe lloje të ngjashme bimësh në kulmet e shtëpive të njerëzve. Kulmi i mbjellë me bimë është njëra e izolimeve më të mira, e kjo është për shkak se në dimër ruan nxehtësinë brenda, kurse në verë nuk lejon të ngrohet sipërfaqja e kulmit. Me atë Ju fitoni edhe një sipërfaqe më e madhe me gjelbërim.

Mbledhja e ujit të shiut
Me mbledhjen e ujit të shiut nga kulmet e shtëpive Tuaja, Ju keni një ujë teknik për ujitjen e kopshtit Tuaj, larjen e rrobave Tuaja dhe të automobilit Tuaj. Mes një e treta dhe një e gjysma e nevojave vjetore për ujë të një familjeje mesatare mund të mblidhet nga një kulm. Pse të humbet ai ujë i shiut në kanalizimet, kur mund të shfrytëzohet në mënyrë racionale.

Kompostimi
Mbeturinat organike nga kuzhina dhe nga kopshti mund të kompostohen. Ai është ushqimi më i mirë për bimët Tuaja. Pse të paguani për plehrrat artificiale, kur Ju mund t'i bëni vetë për nevojat Tuaja shtëpiake!



Standby
Funksioni Standby të aparateve elektrike harxhon shumë energji. Harxhimi është prej 5 - 15% nga harxhimi i zakonshëm aparateve kur ata punojnë. Kjo në vlerë të parë paraqet një harxhim i madh.

Ngruhja e ujit me energjinë e diellit
Mënyra më e thjeshtë e përdorimit të energjisë së diellit është të vini në oborr një fuçi me ujë, fuçi e cila është e ngjyrosur me ngjyrën e zezë dhe në atë pas një kohë do të keni ujë të nxehtë. Sistemi më i përsosur për fitimin e ujit të nxehtë sanitar është Paneli solar i cili vendoset në kulm, kurse me atë mund të fitoni prej 60 deri më 80% nga harxhimi vjetor i ujit të nxehtë.

Transporti
Bicikletat, këpucët me rrota, trotinetet janë mjete të shëndosha dhe zbavitëse transportuese. Në qytet biçikleta është mjeti ideal për transport! Me biçikletë Ju arrini deri te destinacioni Juaj më shpejt, nuk harxhoni karburant, nuk e ndotni ajrin, nuk Ju nevojitet vend të madh për parking dhe nuk merrni hapësirë siç është rasti me automobilin Tuaj. Kur lëvizni me biçikletë, kini kujdes në shenjat komunikacioni dhe në veturat motorike rreth Jush!



Ngruhja
Në amvisëritë për ngrohjen shfrytëzohet prej 60 deri 70% nga harxhimi i përgjithshëm i energjisë. Njëkohësisht ajo paraqet mundësi ku mund më së shumti të rritet kursimi i energjisë. Nëse zvogëloni temperaturën e dhomës për 2°C, atëherë përdorni më pak energji për 10 deri 12%. Temperatura ideale e dhomës është 21°C. Nëse është tepër e nxehtë atëherë zvogëloni temperaturën e trupit ngrohës, kurse nëse e keni të ftohtë vishni veshje më të trashë.

Dyert, dritaret
Dyert dhe dritaret që janë izoluar mirë me qelq të dyfishtë ose me material izolues (shirita silikon, gome dhe syngjeri) do t'ju ndihmojnë ta ruani nxehtësinë brenda shtëpisë. Në dimër, nxehtësi mund të merrni nga rrezet e diellit të cilat kalojnë nëpër qelqin, kurse pas perëndimit të diellit mbyllni perdet dhe lëshoni roletat që të mos humbni nxehtësinë nëpër dyert dhe dritaret.

Muret
Një shtresë e hollë izolimi të murit është përgjegjëse për humbjen më të madhe të nxehtësisë. Muret që janë izoluar mirë mbajnë nxehtësinë që të mbetet në dhomat, kurse në verë ftohin dhomat. Muret e trasha mbajnë temperaturën konstante në tërë shtëpinë.

Ndriçimi
Drita natyrore është burimi më i shëndoshë i dritës, prandaj sipas mundësisë shfrytëzoni deri në maksimum. Kur zgjidhni llamba mendoni për atë se ku dhe pse Ju nevojiten. Kur i lini llambat të ndriçojnë pa nevojë Ju harxhoni energji pa nevojë. Kur lexoni shfrytëzoni llamba që fokusojnë dritën, ndërsa kur shfrytëzoni llamba për një kohë të gjatë atëherë shfrytëzoni llamba që kursejnë energji!

Përdorimi i ujit
Uji i pijshëm është një nga pasuritë tona më të mëdha dhe nëse nuk e harxhoni pa nevojë atëherë Ju kurseni energji. Përmes çezmës së dëmtuar dhe përmes kazanëve të prishur të tualeteve, një familje lëshon nga 15 deri më 20 mijë litra ujë, i cili çdo muaj mund të shfrytëzohet për të pirë. Këshilli ynë është që t'i shmangni problemet e kësaj natyre!
Nëse bëni dush atëherë Ju shfrytëzoni një e treta e ujit të cilin do ta shfrytëzoni në banjë.
Nëse makina për larjen e rrobave nuk është e mbushur deri në mes, atëherë asaj i nevojitet sasi e dyfishtë energjie për t'i larë rrobat në rastin kur ajo është e mbushur deri maksimum. Nëse i lani rrobat në temperaturë prej 40°C, a jo në temperaturë prej 60°C atëherë Ju harxhoni dyfishtë më pak energji.

Aparatet elektrike
A na duhet në të vërtetë një aparat elektrik për çdo qëllim? Nëse mendoni mirë atëherë do të kuptoni se mund të punoni në kuzhinë dhe në kopsht ku keni më pak aparate elektrike. Kur do t'i hiqni aparatet e panevojshme elektrike Ju do të kurseni para, kurse në vitet e ardhshme nuk do t'ju mbeten aparate elektrike të vjetërsuara dhe të padëshiruara, të cilat pastaj do të duhet t'i hidhni.
A keni ditur se për prodhimin e një baterie nevojitet më shumë energji sesa vetë ajo bateri do të prodhon energji gjatë periudhës përdorimit të saj? Po ashtu është e rëndësishme se kur do të prishet bateria, duhet ta hidhni atë dhe ajo paraqet rrezik për ambientin jetësor. Prandaj, nëse shfrytëzoni bateri, atëherë shfrytëzoni ato që mund të mbushen sërish (rechargeable). Në atë mënyrë Ju nuk do të bëni mbeturinë aq e madhe dhe e rrezikshme për ambientin jetësor.

Kuzhina
Ja disa këshilla të lehtë dhe të thjeshtë si ta zvogëloni harxhimin e energjisë elektrike derisa gatuani gjellë. Gjatë gatimit kini kujdes që gjithmonë ta vini kapakun e tenxheres dhe madhësia e tenxherëve të jetë e ngjashme ose e njëjtë me madhësinë e ringlës (plakës). Me këtë Ju do të kurseni edhe kohë edhe energji gjatë gatimit. Nëse nuk e hapni derën e rernës shpesh atëherë nuk do ta humbni nxehtësinë e brendshme.